

**Njoftim për përqendrim me të cilin shoqëria Robert Bosh Internacionale Betajligungen AG. Zvicër
fiton kontroll të vetëm mbi shoqërinë Elpro Grup AG., Zvicër**

(lënda nr. 08-36/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 02.02.2022, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin shoqëria "Robert Bosh Internacionale Betajligungen AG (*Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG*), me seli në Luterbahstrase 10, 4528 Cuhvil, Zvicër do të fitoj kontroll të vetëm shoqërinë" Elpro Grup AG" (*Elpro Group AG*), me seli në Langojlishtrase 45, 9470 Buhs SG, Zvicër.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktiviteti i tyre i biznesit :

Robert Bosh Internacionale Betajligungen AG (*Robert Bosch Internationale Beteiligungen AG*) është ndërmarrje 100% në pronësi të "Robert Bosh" GmbH (*Robert Bosch GmbH*) (së bashku „**Bosh**").

Bosh është një kompani e cila i takon Grupit Bosh, që është e kontrolluar plotësisht nga "Robert Bosh GmbH" (**Grupi Bosh**). Grupi Bosh ofron teknologji dhe shërbime për industrinë e automobilave, teknologjinë industriale, mallrat e konsumit dhe industrinë e energjisë dhe teknologjinë e ndërtimit në mbarë botën.

Grupi Bosh nuk ka të regjistruara ndërmarrje- simotra në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Elpro Grup AG është një ofrues i shërbimeve gjithëpërfshirëse në drejtim të zgjidhjeve monitoruese të mundësuar nga teknologjia, kritike për misionin specifik të zinxhirëve të furnizimit të kontrolluar nga temperatura në industrinë farmaceutike dhe të kujdesit shëndetësor dhe bio-shkencës. Elpro Grup AG ka ndërmarrje-simotra në 8 shtete: Zvicër, Gjermani, Hungari, Danimarkë, Holandë, Mbretërinë e Bashkuar, SHBA dhe Singapor.

në lidhje me **tregun relevant të mallrave** për përqendrimin në fjalë, parashtruesi propozon që i njëjti mund të përkufizohet si një treg i:

- zgjidhjeve të monitorimit të zinxhirit të ftohtë ose zgjidhjeve të ndjekjes dhe monitorimit të zinxhirit të ftohtë në industrinë farmaceutike dhe të kujdesit shëndetësor dhe bio-shkencën.
- zgjidhjeve për monitorimin e objekteve dhe pajisjeve në Maqedoninë e Veriut

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstaton se përqendrimi në shqyrtim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.02..2022

Shkup

